



Акционерско друштво во државна сопственост  
за вршење на дејноста давање услуги во  
воздухопловната навигација

Shoqëri aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e  
veprimtarisë dhënie të shërbimeve të navigacionit ajror

ShA – M-NAV SHKUP

PLANI FINANCIAR VJETOR PËR VITIN 2024

Nëntor 2024

“Босфор” Бр. 7, Мралино, Илинден  
Република Северна Македонија  
Тел: +389 2 3148100 Факс: +389 2 3148239  
E-mail: [info@mnavigation.mk](mailto:info@mnavigation.mk)



“Bosfor” Nr. 7, Mralino, Ilinden  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
Tel: +389 2 3148100 Fax: +389 2 3148239  
E-mail: [info@mnavigation.mk](mailto:info@mnavigation.mk)

## IDENTIFIKIMI I DOKUMENTIT

**Përshkrimi i dokumentit:** Plani financiar vjetor i M-NAV A.D. Shkupi për vitin 2024 përfshin përfundimin e pasojave të pandemisë Covid-19, konfliktin në Ukrainë, krizën ekonomike, trafikun ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut në 2022/23 dhe skenarët e mundshëm për lëvizjen në vitin 2024, çmimin e vetëm për fluturimet dhe shërbimet terminale për vitin 2024, analiza e të hyrave të planifikuara për vitin 2024, analiza krahasuese e të hyrave të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2024 në lidhje me të hyrat e planifikuara të Shoqërisë për vitin 2023, analiza e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2024, paraqitja tabelare e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2024, rezultati financiar i planifikuar i Shoqërisë për vitin 2024, analiza krahasuese e shpenzimeve të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2024 me shpenzimet e planifikuara të Shoqërisë në vitin 2023, një analizë krahasuese e shpenzimeve të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2024 me shpenzimet e realizuara të Shoqërisë në vitin 2023 dhe të tjera.

## titulli

**SHA "M-NAV" SHKUP**  
PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR VITIN 2024

<b>Numri referues:</b> MHB-610-201-04	<b>Numri i botimit:</b> 1.0 <b>Data:</b> 11/12/2023

## Fjalë kyçe:

"...Planifikimi i të ardhurave të fluturimeve për vitin 2024, bazohet në analizat e trafikut ajror në Republikën e Maqedonisë gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2023, si dhe në skenarët e fundit të përgatitur nga EUROCONTROL-i për numrin e fluturimeve në periudhën e viteve 2020-2024 ."

**Vëllimi i trafikut, të ardhurat e planifikuara, shpenzimet e planifikuara, të ardhurat e realizuara, shpenzimet e realizuara, të ardhurat e përgjithshme, shpenzimet e përgjithshme.**

<b>Statusi i dokumentit:</b>	Versioni i punës		<b>Klasifikimi:</b>	Dokumenti i brendshëm	
	Versioni i saktë	√		Dokumenti publik	√
	Botimi i shpallur			<b>I besueshëm</b>	

<b>Lokacioni:</b>	<b>Shkup</b>
-------------------	--------------

ShA "M-NAV" Shkup – Plani financiar vjetor i vitit 2024**PRANIMI I DOKUMENTIT**

Në tabelën vijuese janë paraqitur autorët dhe personat të cilët e kanë përpunuar/miratuuar këtë dokument.

Funksioni	Emri, mbiemri dhe nënshkrimi	Data
Punuan:	Filip Trandafilovski Udhëheqës i Departamentit të Planifikimit, Zhvillimit dhe Huamarrjes Ndërkombëtare.	

	<p>Daniela Trajçulleska Udhëheqëse e Departamentit për Çështje Financiare dhe Administratë</p> <p>Dejan Zaraqçiev Këshilltar i pavarur për përcaktimin e çmimeve</p>	
Kontrolloji Aspekti - cilësia	<p>Leonora Shala Udhëheqëse e Departamentit për Cilësi - Siguri në Departamentin e Sistemeve të Menaxhimit të Integruar</p>	
Miratuan	<p>Fahrudin Hamidi Kryetar i Këshillit Drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Navigacionit ajror</p> <p>Lube Stamenovski Anëtar i Këshillit Drejtues dhe Drejtor Ekzekutiv i Aviacionit Teknik</p> <p>D-r Hasim Deari Anëtar i Këshillit Drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Çështjeve Financiare, i Çështjeve Juridike, Zhvillim dhe i Investimeve</p>	

## PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	5
2.	Efektet e pandemisë COVID-19 dhe lufta në Ukrainë - Konteksti Evropian.....	7
2.1.	Parashikimi i Eurocontrol – STATFOR-it për trafikun ajror 2023-2029 (Botimi Tetor 2023).....	8
3.	Trafiku ajror në R.M.V në vitin 2023 dhe skenarët e mundshëm për lëvizjen në vitin 2024.....	9
3.ÇMIMI I VETËM I FLUTURIMEVE AJRORE NË VITIN.....		12
4.1,	Analizë krahasuese e të ardhurave të planifikuara të shoqërisë për vitin 2024 krahasuar me ato të planifikuara për vitin 2023	
5.	ANALIZA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2024.....	15
6.	REZULTATI FINANCIAR I PLANIFIKUAR PËR VITIN 2024.....	18
7.	PASQYRA TABELARE E TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA TË ShA “M-NAV” SHKUP PËR VITIN 2021.....	19
8.	PASQYRA TABELARE E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA TË ShA “M-NAV” SHKUP PËR VITIN 2021.....	20
9.	ANALIZA KRAHASUESE E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA TË ShA M-NAV SHKUP PËR VITIN 2024 ME SHPENZIMET E PLANIFIKUARA TË SHOQËRISË PËR VITIN 2023.....	22
10.	ANALIZA KRAHASUESE E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA TË ShA “M-NAV” SHKUP PËR VITIN 2021, ME SHPENZIMET E REALIZUARA TË SHOQËRISË PËR VITIN 2023.....	24

## Hyrje

Në bazë të nenit 60 të Ligjit të Aviacionit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.14/06, 24/07, 103/08, 67/10, 24/12, 80/12, 155/12, 42/14, 97/15, 152/15, 27/16, 31/16 и 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr, 220/19), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për kryerjen e shërbimeve të navigacionit themelon Shoqëri Aksionare menjë aksionar, shteti –dhënës i shërbimeve të navigacionit ajror, në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare.

Mënyra e themelimit, veprimtaria dhe mënyra e drejtimit rregullohen me aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur më 16.10.2008 ka marrë Vendim për fillimin e procedurës për themelimin e Shoqërisë Aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë dhënës të shërbimeve të navigacionit ajror nr. 19-4602/1.

Në përputhje të Statusit aktual të lëshuar nga Regjistri Qendror, data e themelimit të Shoqërisë ShA M-NAV Shkup është 04.11.2008.

Më 10 mars 2010, shoqëria M-NAV ShA Shkup ka marrë Certifikatën e Kompetencës për dhënie të shërbimeve të navigacionit ajror MK-01/2010ANSP, me vlefshmëri dyvjeçare, të lëshuar nga Agjencia e Aviacionit e Aviacioni Civil, e cila pas kontrollit të plotësimit të kushteve të nevojshme, të njëjtën e ripërtërin rregullisht. Certifikata e vlefshme e kompetencës për dhënie të shërbimeve të navigacionit ajror me numër MK01-2022/ANSP është lëshuar në mars 2022.

Me Vendim për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë Aksionare në pronë Shtetërore për kryerjen e Veprimtarisë së Dhënësit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 70/19) dhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Shoqërisë Aksionare Shtetërore në pronë shtetërore për kryerjen e veprimtarisë dhënie të shërbimeve në navigacionin ajror ShA M-NAV Shkup (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 24/20) emri i shoqërisë është ndryshuar, sipas të cilit Shoqëria Aksionare vepron dhe merr pjesë në qarkullimin ligjor me emrin: Shoqëri aksionare në pronë shtetërore për kryerjen e veprimtarisë dhënie të shërbimeve në navigacion ajror ShA M-NAV Shkup. Emri i shkurtuar i shoqërisë është: ShA "M-NAV"- Shkup. Emri i Shoqërisë shkruhet edhe në gjuhën që flasin të paktën 20% e qytetarëve dhe shkrimin e saj dhe shkruhet: „Shoqëria Aksionare në Pronësi Shtetërore për Kryerjen e Veprimtarisë së Dhënies së Shërbimeve në Navigacionin Ajror M-NAV SHA Shkup.. Emri i shkurtuar i firmës në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimi i saj është: ShA M-NAV Shkup. Në transaksionet juridike me shtetet e huaja, emri i Shoqërisë është M-NAV” Air Navigation Service Provider of the Republic of North Macedonia, GOJSC.

Në bazë të nenit 8 të Statutit të shoqërisë aksionare shtetërore për kryerjen e veprimtarisë dhënie të shërbimeve në navigacionin ajror ShA M-NAV Shkup (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”

nr. 31/20 – tekst i konsoliduar) kapitali bazë i Shoqërisë arrin 1.552 034.000,00 denarë ose 25.226.275,71 euro i ndarë në 1.552.034 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1.000,00 denarë për aksion.

Në përputhje të Statutit të ShA "M-NAV" Shkup- Menaxhimi i Shoqërisë është i organizuar sipas një sistemi dy nivelesh. Shoqëria ka Këshill Drejtues Këshill Mbikëqyrës. Këshilli drejtues përbëhet nga tre anëtarë. Këshilli Mbikëqyrës i zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i votave. Me vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues, një nga anëtarët e Këshillit Drejtues emërohet Kryetar i Këshillit Drejtues. Një nga anëtarët e Këshillit Drejtues drejton, organizon dhe përgjigjet për mjetet teknike në navigacion ajror dhe mban titullin, drejtor ekzekutivë teknikën e Aviacionit.

Anëtari zgjidhet nga radhët e punonjësve dhe duhet të ketë njohuri profesionale, aftësi dhe përvojë në organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të Shoqërisë, të ketë licencë të vlefshme për personelin teknik të Aviacionit dhe të paktën 6 vjet përvojë pune personeli aviacioni teknik. Një nga anëtarët e Këshillit Drejtuesudhëheq, organizon dhe është përgjegjës për dhënie të shërbimeve në navigacionin ajror dhe mban titullin, drejtor ekzekutiv përnavigacion ajror. Anëtari zgjidhet nga radhët e punonjësve dhe duhet të ketë njohuri profesionale , aftësi dhe përvojë në organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë së Shoqërisë, të posedojë një licencë të vlefshme për kontrollor mbikëqyrës të fluturimeve dhe të paktën 6 vjet përvojë pune si mbikëqyrës kontrollor i fluturimeve.

Një nga anëtarët e Këshillit Drejtues udhëheq, organizon dhe është përgjegjës për pajisjet teknike në navigacionin ajror dhe mbajnë titullin "Drejtor Ekzekutiv për Teknikë të Aviacionit". Anëtari zgjidhet nga radhët e punonjësve dhe duhet të ketë njohuri profesionale, aftësi dhe përvojë në organizimin dhe udhëheqjen e veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe duhet të posedojë licencë të vlefshme për personelin teknik të aviacionit dhe të ketë të paktën 6 vjet përvojë pune si personeli aviacioni teknik. Njëri nga anëtarët e Këshillit Drejtues drejton dhe kryen punët financiare, çështjet juridike, zhvillim dhe investime dhe është përgjegjës për çështjet financiare, çështjet juridike, zhvillimin dhe investimet dhe mban titullin, drejtor ekzekutiv për çështje financiare, çështje juridike, zhvillimin dhe investimet.

Anëtari duhet të ketë njohuri, aftësi dhe përvojë profesionale në organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe të paktën 6 vjet përvojë pune në një aktivitet përkatës. Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen për një periudhë 4 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje. Anëtari i Këshillit Drejtues nuk mund të zgjidhet anëtar i këshillit drejtues, përkatësisht anëtar ekzekutiv i këshillit të drejtorëve të shoqërive të tjera aksionare me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të ShA "M-NAV" - Shkupi janë:

- Fahrudin Hamidi i zgjedhur me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të ShA M-NAV Shkup nga 30.10.2020, i cili udhëheq, organizon dhe është përgjegjës dhënie të shërbimeve në navigacion ajror dhe mban titullin - Drejtor Ekzekutiv për Navigacion Ajror. Personi i emëruar është edhe Kryetar i Këshillit Drejtues;
- Lube Stamenkovski i zgjedhur me vendim të Këshillit mbikëqyrës të ShA "M-NAV". - Shkup nga 08.06.2023, i cili udhëheq, organizon punën dhe përgjigjet për mjetet teknike në navigacion ajror dhe mban titullin Drejtor ekzekutiv për teknologji të aviacionit; dhe
- Hasim Deari i zgjedhur me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të ShA "M-NAV" - Shkup nga 13.03.2023 i cili udhëheq dhe ushtron punë financiare, punë juridike, zhvillim dhe investime dhe është përgjegjës për çështje financiare, punë juridike, zhvillim dhe investime dhe mban titullin Drejtor Ekzekutiv për Çështje Financiare, Çështje Juridike, Zhvillim dhe Investime. .

### **Lënda e punës në SHA "M-NAV" Shkup**

Lënda e punës së Shoqërisë përfshin këto veprimtari:

1. Dhëni i shërbimeve të navigacionit ajror (ANS - Air Navigation Services) si aktivitet prioritar i Shoqërisë, i cili përfshin:

1.1 Shërbime të MTA-së (Air Traffic Management) :

a) shërbimet ATC (ATS-Air Traffic Services):

- kontrolli i fluturimeve (ATC - Air Traffic Control), i cili jep aprovim dhe udhëzime për kontrollin e fluturimeve për të mundësuar një qarkullim të sigurt, të rregullt dhe të shpejtë të trafikut ajror;

-informacioni gjatë fluturimit (FIS - Flight Information Service), i cili jep informacione të rëndësishme për sigurinë e përgjithshme të trafikut ajror; dhe

- alarmi (ALRT – Alerting Service) i cili jep sinjalizim mjeteve të fluturimit që kanë nevojë për operacione kërkimi dhe shpëtimin duke njoftuar dhe koordinuar subjektet kompetente.

b menaxhimi i rrjedhës së trafikut ajror (ATFM - Air Traffic Flow Management), i cili jepet për të mundësuar përdorimin maksimal të kapacitetit të kontrollës së fluturimeve dhe volumit të trafikut.

c.) menaxhimi i hapësirës ajrore (ASM – Air Space Management), me çka mundësohet shfrytëzimi maksimal dhe fleksibël i hapësirës ajrore për të gjithë shfrytëzuesit dhe

ç) funksionet e rrjetit (Network functions), janë shërbime që jepen për të siguruar aranzhmanë për sjelljen e vendimeve të përbashkëta ndërmjet shteteve anëtare, dhënësit e shërbimeve të navigacionit ajror dhe funksioni për menaxhimin e rrjetit.

1.2. Shërbimet e informacionit ajror (AIS - Aeronautical Information Service), që përfshijnë: mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacioneve ajrore, njoftimet urgjente, qarkullimin informativ ajror, hartat ajrore dhe procedurat për fluturim;

1.3. Shërbimet meteorologjike që përfshijnë mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit meteorologjik, parashikimin meteorologjik, njoftimet meteorologjike dhe paralajmërimet meteorologjike;

1.4. Vendosja, mbajtja, kontrolli dhe monitorimi i pajisjeve teknike, aparateve dhe pajisjeve për të siguruar shërbime të navigacionit ajror, duke përfshirë mirëmbajtjen parandaluese dhe korrektuese, përshtatjen, kalibrimin, monitorimin, mbikëqyrjen, menaxhimin, vendosjen dhe nisjen e tyre në punë, si dhe zhvillimin dhe ndryshimin e procedurave dhe udhëzimeve për operacionet dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknike operative në gjendje që të mundësojë një trafik ajror të sigurt dhe të rregullt (CNS Services).

2 Përdorimi dhe ruajtja e të dhënave për evidentimin, mbledhjen, përpunimin dhe dërgimin e të dhënave që përdoren për pagesën e kompensimeve për shërbimet e navigacionit ajror.

3. Përgatitja dhe përditësimi i rregullt i Pëmbledhjes për informatat e aviacionit.

4. Trajnimi i personelit të ANS

#### **Dhënësi i shërbimeve të navigacionit ajror, financohet nga:**

- Pjesa e kompensimit të realizuar bazuar në dhënie të shërbimeve të navigacionit ajror, e cila përcaktohet me një listë të shpenzimeve të dhënësit të shërbimeve të navigacionit ajror në mënyrën e caktuar në përputhje me Neni 56 paragrafi (4) të Ligjit për aviacionin;

- kompensimi për trajnimin e personelit të ANS-së

- taksat, huatë, kreditë dhe ndihma të tjera financiare dhe teknike.

## **2.EFEKTET E PANDEMISË SË COVID-19 DHE LUFTA NË UKRAINË - KONTEKSTI EVROPIAN**

Mund të thuhet se rikuperimi nga pandemia Covid-19 kryesisht ka mbaruar, por duhet marrë parasysh se trafiku në nivel evropian është ende i prekur nga lufta në Ukrainë, me dallime të konsiderueshme midis rajoneve të ndryshme të Evropës. Për shkak të pamundësisë për të parashikuar përfundimin e luftës në Ukrainë, parashikimet janë përgatitur duke marrë si bazë statusin aktual.


Situata me konfliktin prek veçanërisht sektorin energjetik, e me këtë edhe parashikimet e rritjes ekonomike në Eurozonë. Me uljen e fuqisë blerëse të konsumatorit dhe rrjedhimisht kërkesës për udhëtime, ndikimi reflektohet edhe në trafikun ajror. Nga ky faktor i ri ndikohet veçanërisht edhe ngarkesa ajrore, me kufizime të mëdha operacionale për transportuesit kryesorë dhe zinxhirë e furnizimi të ndërprerë. Pranë të përmedhurës, mundësia e rritjes së inflacionit, rreziqet ekonomike dhe shqetësimet mjedisore e bëjnë të vështirë parashikimin e saktë të volumit të trafikut në vitin 2024, si dhe implikimet e mundshme financiare për Shoqërinë.

### **2.1. Parashikimi i Eurocontrol – STATFOR për trafikun ajror 2023-2029/ (Botimi i datës tetorë 2023)**

Parashikimi i fundit i trafikut ajror i lëshuar nga Eurocontrol - STATFOR në tetor 2023 merr

parasysh këto inpute:

**Trendet e trafikut ajror: 91% në nivel të fluturimeve në janar – tetor të vitit 2023, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2019.**




• **Rritja ekonomike**

Rishikimi i fundit i parashikimeve të BPV- në Eurozonë solli në rritje të caktuar të parashikuar për vitin 2023 për shkak të çmimeve më të ulëta se sa pritej të energjisë, rritjes së besimit në ekonomi dhe një tregu të fuqishëm të punës, por në të njëjtën kohë një korrigjim të vogël në drejtim të kundërt për vitet 2024 dhe 2025, kryesisht për shkak të kushteve të kufizara financiare. E gjithë kjo çon në një rritje të nivelit të pasigurisë dhe rreziqeve që ndikojnë negativisht në parashikimet.

**ECONOMIC GROWTH**

GDP baseline forecast slightly revised upwards in 2023 but downward in 2024 and 2025.



- Slight upward revision in 2023 of the baseline projections of Oxford Economics driven by **lower energy prices, enhanced business confidence**, and a **robust labor market**.
- Downward revision in 2024 and 2025 influenced by **worsening survey indicators**, more **restrictive financing conditions**, including adverse credit supply effects, and the strengthened euro exchange rate.
- Uncertainty remains very high, with **risks** skewed to the **downside**.




## • Parashikimi i trafikut

Rritja e trafikut në vitin 2024 është parashikuar në nivel lokal, ku pritet të arrihet 100% e nivelit të vitit 2019 për rajonin ECAC gjatë muajve të verës të vitit 2024, me një rritje mesatare të parashikuar prej 1.6% në periudhën 2025-2029.



### EUROCONTROL STATFOR 7-YEAR FORECAST UPDATE FOR \*EUROPE 2023-2029 (Autumn 2023)

Actual and future IFR movements



\* Europe = ECAC 44 Member States

Source:  
EUROCONTROL 7-year Forecast 2023-2029, Autumn 2023.

EUROCONTROL Seven-Year Forecast Update 2023-2029

Document Confidentiality Classification: White


8

### 3. TRAFIK AJROR NË REPUBLIKËN E MAQEDONIS SË VERIUT NË VITIN 2023 DHE SKENARET E MUNDSHME PËR LËVIZJEN NË 2024

Nga viti 2022, trafiku ajror është stabilizuar në tërësi nga pasojat e pandemisë Covid-19 me një rritje prej 1,1% në shtator krahasuar me vitin referues 2019, pra vitin para pandemisë. Ky trend i rritjes së trafikut ka vazhduar mjaft intensivisht edhe në vitin 2023, me rezultat që rritja e trafikut ajror krahasuar me vitin 2019 është 16.3% në shtator.


Raporti i trafikut total nga fillimi i çdo viti që përfundon me muajin shtator, krahasuar me vitin referues 2019, tregohet në grafikun e mëposhtëm.

All traffic from 2019 to 2023 vs 2019 for period Jan-Sep



Dita me më shumë operacione në vitin 2023 është e diela, 27 gusht me gjithësej 1181 operacione. Grafiku i mëposhtëm tregon evolucionin mujor të trafikut total për periudhën 2019-2023. Shifra e treguar në përqindje tregon rritjen e konsiderueshme mujore të trafikut në vitin 2023 krahasuar me muajin korrespondues të vitit referues 2019.

All LWSS traffic from 2019 to 2023




Dhe këtë sezon veror, kushtet e këqija të motit shkaktuan nevojën e vendosjes së rregulloreve, të cilat krijuan një vonesë të caktuar në rrjet dhe ulje të numrit të fluturimeve në periudhat e prekura. Gjithashtu, shpërndarja e pabarabartë e trafikut, e cila ka tejkaluar kapacitetet e përcaktuara të sektorit, kushtëzoi nevojën e rregulloreve për mbrojtjen e sektorëve nga mbingarkesa. Gjatë vitit 2023, rritja e madhe e trafikut bëri që në disa orë trafiku të tejkalonte numrin prej 72 avionësh në orë, duke arritur deri në 90 avionë në orë. duke arritur deri në 90 avionë në orë. Kjo situatë rezultoi në nevojën e futjes së rregulloreve për mbrojtjen teknike të sistemit të vjetëruar të ATM-ve.

Kushtet e motit janë të paparashikueshme dhe vendosja e rregulloreve për këtë arsye nuk mund të shmanget. Pas kalimit në sistemin e ri ATM Leonardo, kufizimi teknik prej 72 mjete fluturimi në orë do të tejkalohet plotësisht dhe në periudhën që do të pasojë kalimi dhe miratimi i përdorimit të qëndrueshëm të sistemit të ri ATM nga stafi operativ, do të bëhet një vlerësim. të kapaciteteve të sektorit do të kryhen me qëllim rritjen e tyre dhe optimizimin e përdorimit të hapësirës ajrore, kështu që do të reduktohet

nevoja për futjen e rregulloreve për shkak të tejkalimit të kapaciteteve sektoriale.


Më poshtë është pjesa e arsyeve të vendosjes së rregulloreve dhe vonesës së shkaktuar të fluturimit të dhënë në minuta, në periudhën nga 1 prilli deri më 31 gusht 2023.

### Regulations 2023



Vëllimi i trafikut në aeroportet e Shkupit dhe Ohrit, i dhënë në grafikun e mëposhtëm. Shifra e treguar në përqindje tregon rritjen mujore të trafikut në vitin 2023 krahasuar me muajin korrespondues të vitit referues 2019. Për dallim nga viti 2022, trafiku i aeroportit në vitin 2023 ka tejkaluar trafikon e vitit 2019.

### LWSS aerodromes from 2019 to 2023



Pavarësisht rritjes së madhe të trafikut ajror, kushteve të pafavorshme atmosferike dhe kufizimeve për shkak të sistemit të vjetëruar të ATM-ve, sezoni veror u përfundua në mënyrë të sigurt dhe efikase, duke ofruar shërbim maksimal profesional për përdoruesit.

Në fakt, në dhjetë muajt e parë të vitit 2023 (periudha janar-tetor) janë realizuar gjithsej 237.897 mbifluturime, nga të cilat 218.573 janë mbifluturime, të dhëna që tregojnë një rritje prej 13.3% krahasuar me numrin e mbifluturimeve në të njëjtën periudhë të vitit 2022. Sipas statistikave të Byrosë Qendrore të Faturimit Eurocontrol për dhjetë muajt e parë të vitit 2023, Republika e Maqedonisë së Veriut ka shënuar rritje prej 16,7% në njësitë e faturimit të fluturimeve në raport me ato të planifikuara për vitin 2023 ose një rritje prej 15,5% në raport. për të njëjtën periudhë të vitit 2022.

Month	2023 Actual	2023 Unit Rate Basis	2022 Actual	2019 Actual	% 2023 A / 2023 F	% 2023 A / 2022 A	% 2023 A / 2019 A

		(1)	(2)	(3)	(6)	(1)/(2)	(1)/(3)	(1)/(6)
1	January	23,893	17,608	17,786	17,708	35.7%	34.3%	34.9%
2	February	23,681	15,222	15,376	16,639	55.6%	54.0%	42.3%
3	March	30,228	22,944	23,176	19,233	31.7%	30.4%	57.2%
4	April	38,103	31,997	32,321	28,427	19.1%	17.9%	34.0%
5	May	47,766	42,774	43,206	40,456	11.7%	10.6%	18.1%
6	June	52,333	48,559	49,050	45,978	7.8%	6.7%	13.8%
7	July	57,365	52,460	52,991	50,551	9.3%	8.3%	13.5%
8	August	57,317	50,048	50,553	50,618	14.5%	13.4%	13.2%
9	September	54,508	44,974	45,428	45,339	21.2%	20.0%	20.2%
10	October	45,432	42,363	42,792	37,975	7.2%	6.2%	19.6%
11	November		23,087	23,320	20,607			
12	December		22,865	23,096	21,469			
<b>TOTAL</b>		<b>430,627</b>	<b>414,900</b>	419,094	395,000	<b>16.7%</b>	<b>15.5%</b>	<b>22.0%</b>

Paraqitja tabelare e Byrosë Qendrore të Faturimit të Eurocontrol për njësitë e faturimit të realizuara nga fluturimet mbi RMV në periudhën prej 01.01 deri më 30.10.2023

Parashikimi i Eurocontrol për periudhën 2023-2029 (tetor 2023), i cili merr parasysh ndikimin e efekteve të invazionit rus të Ukrainës, si dhe krizën financiare, shënuar në tabelën më poshtë. Sipas tre skenarëve të rritjes së trafikut në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023, rritja e numrit të përgjithshëm të fluturimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2024 pritet të lëvizë ndërmjet 1,0% (në skenarin pesimist) dhe 9,6% (në një skenar optimist), për faktin se ka ende një shkallë të lartë pasigurie në evoluimin e trafikut ajror për shkak të rreziqeve aktuale që rrjedhin nga lufta në Ukrainë dhe tensionet gjeopolitike në Lindjen e Mesme.

#### R.E MAQEDONISË SË VERIUT

	rritje e trafikut në krahasim me vitin e kaluar (përqindje)									
Skenar	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
optimiste					18.0%	9.6%	4.2%	4.1%	3.6%	3.4%
bazike	17.4%	-56.0%	58.0%	52.0%	17.0%	5.5%	2.8%	2.7%	2.1%	2.1%
pesimiste					15.0%	1.0%	1.2%	1.1%	0.4%	0.6%


- Rritje e trafikut në RMV në periudhën 2023-2028 (sipas skenarëve të Eurocontrol)

#### 4.ÇMIMI I VETËM I MBIFLUTURIMEVE AJRORE GJATË VITIT 2023

Metodologjia e përllogaritjes së çmimit të njësisë së mbifluturimeve, bazohet nga sistemi i përbashkët i pagesës së kompensimeve të mbifluturimeve, në përputhje me rregullativën nr.1794/06 të Komisionit Europian, si dhe vendimit të Qeverisë së RMV-së, për mënyrën e përcaktimit të shumës së kompensimit, për shfrytëzimin e shërbimeve të navigacionit ajror, mënyrës së pagesës dhe lirimi nga pagesa e kompensimit, si dhe shumës dhe mënyrës së përcaktimit të pjesës së

kompensimit të shfrytëzimit të shërbimeve të navigacionit ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.194 më 23.9.2019). Informacioni për llogaritjen e çmimit të mbifluturimeve dorëzohet, shqyrtohet dhe më pas miratohet nga ana e Eurocontrol-it dhe pilotëve, gjatë mbledhjes këshilluese, që organizohet çdo vit. Përveç kësaj, në këtë mbledhje shkëmbehen informacionet e shpenzimeve të përgjithshme të planifikuara, investimet, si dhe projeksion i trafikut, për çdo vit vijues. Sipas harmonizimit të kryer ndërmjet ShA "M-NAV" Shkup dhe Agjencisë së Fluturimeve Civile të RMV-së, si organ rregullativ, çmimi i vetëm i mbifluturimeve në RMV për vitin 2024, është përcaktuar të jetë **47,40** euro, që gjithashtu paraqet një rënie prej 4.1% krahasuar me nivelin e vitit 2023.

#### Paraqitja grafike e lëvizjes së çmimit për njësi për fluturimet në RMV në periudhën 2012 – 2024



Vlen të theksohet fakti se me rritjen e trafikut në periudhën e kaluar dhe të ardhurat nga rritja e vëllimit të shërbimeve të ofruara, u krijuan parakushtet për uljen e çmimit të mbiflurimeve. Rrjedhimisht, në vitin 2024, çmimi për njësi për mbiflurimet do të ulet me 4.1% krahasuar me vitin 2023 dhe i njëjti bazohet në supozimet e normalizimit të kushteve të trafikut ajror dhe në projeksionin e fundit për një rritje të njësisive të tarifimit nga mbiflurimet midis 1.0 % dhe 9.6% në 2024 krahasuar me numrin e njësisive të faturimit të realizuara në 2023.

#### ÇMIMI I VETËM I “M-NAV”-it PËR SHËRBIMET TERMINALE NË VITIN 2021

Një pjesë më e vogël (14.5%) e të hyrave totale të planifikuara në vitin 2024 ShA M-NAV. Shkupi pret të realizojë si ofruar të shërbimeve terminale të navigacionit ajror, përkatësisht shërbimeve të fluturimeve gjatë ngritjes dhe uljes në aeroportet e Shkupit dhe Ohrit. Nga këto shërbime në vitin 2024 priten të hyra prej rreth 203 milionë denarë, që paraqet edhe rritje prej rreth 23,0% në raport me të hyrat totale të planifikuara nga shërbimet e terminalit në vitin 2023, në përputhje me normalizimin e planifikuar të gjendjes në trafikun ajror dhe rritja e numrit të operimeve terminale (ngritje/zbritje) në aeroportet në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2024. Sipas Marrëveshjes për huas me Bankën Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim e financimit të “Projektit për ndërtimin e sistemit të navigacionit ajror” në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe për servisim efikas të detyrimeve të të njëjtit, çmimi i vetëm i shërbimeve terminale në vitin 2024 do të jetë 4.00 euro për ton peshë maksimale të ngritjes së një avioni.

#### ANALIZA E TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2024

ShA “M-NAV” Shkup realizon të ardhura nga veprimtaria e tij, në bazë të pagesës së:

- Kompensim dhënie të shërbimeve të mbiflurimeve – faturimit dhe pagesës që në emër, a në llogari të SHA “M-NAV” Shkup e kryen EUROCONTROL-CRCO (Central Route Charges Office);
- Kompensimi dhënie të shërbimeve terminale të navigacionit ajror – faturimit dhe pagesës që në emër, por në llogari të SHA M-NAV Shkup po ashtu e kryen EUROCONTROL-CRCO
- Të ardhurave nga shërbimet e tjera (dhënie të shërbimeve komunikuese dhe të radarit të Hungarocontrol-it nga ana e ShA M-NAV Shkup);
- Të ardhura të tjera (të ardhura nga vitet e mëparshme, donacionet, qiratë etj.); dhe
- Kompensim për trajnimet e personelit të ANS-së.

Planifikimi i të ardhurave të mbiflurimeve në vitin 2004, bazohet në analizat e trafikut ajror në

Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2023, si dhe në skenarët e fundit të përgatitur të EUROCONTROL-it, për numrin e fluturimeve gjatë periudhës ndërmjet viteve 2023-2029.

Sipas kësaj analize, për periudhën janar-dhjetor të vitit 2024, parashikohet të realizohen gjithsej të ardhura me vlerë **1.407.358.866,00** denarë, prej të cilave **1.191.475.600,50** denarë të ardhura nga mbifluturimet, **203.583.265,50** denarë janë të ardhura për shërbimet terminale dhe **12.300.000,00** denarë të ardhura për shërbime të tjera në bazë të ofrimit sigurimit të imazhit radar dhe shërbimeve të komunikimit të Hungarocontrol-it dhe të ardhura të tjera nga publikimi i informatave të aviacionit, të ardhurave për vitet e mëparshme, kompensimi i dëmeve, donacionet dhe të tjera.

Të ardhurat planifikohen çdo tre muaj, në tremujorin e parë të vitit 2024 pritet të realizohen

**228.067.338,00** denarë, në të dytin planifikohet të realizohen **398.156.412,00** denarë, në të tretin **486.296.551,50** denarë, kurse në tremujorin e katërt pritet të realizohen të ardhura prej

**294.838.564,50** denarësh, që dëshmon karakterin sezonal të trafikut, i cili njëkohësisht reflekton edhe te të ardhurat.

Struktura e të ardhurave në parashikimet e planifikimit për vitin 2024 pritet të jetë: 84,7% të ardhura nga mbifluturimet, 14,5% të ardhura nga shërbimet terminale dhe 0,8% të ardhura të tjera.

Pasqyra tabelare e të ardhurave totale të planifikuara të "M-NAV"-it për vitin 2021, është dhënë në tekstin e mëposhtëm, Pika 8.

4.1. Analiza krahasuese e të ardhurave të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2021, ndaj të planifikuarave për vitin 2023

TË ARDHURAT	Të planifikuara v.2024	Të planifikuara v.2020	(%) 2024/2023
Të ardhurat e mbifluturimeve	1.191.475.600,50	1.051.719.062,83	13,29%
Të ardhurat e shërbimeve terminale	203.583.265,50	164.800.412,57	23,53%
Të ardhurat e tjera	12.300.000,00	12.000.000,00	1,03%
<b>GJITHSEJ denarë:</b>	<b>1.407.358.866,00</b>	<b>1.228.519.475,40</b>	<b>14,56%</b>

